

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6571  
E martë, 29 mars 2022  
çmimi 0.40 €

Zelensky këmbëngul në  
'integritetin territorial' të  
Ukrainës para bisedimeve  
me Rusinë | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E KULTURËS E KOSOVËS (SBASHK) DHE BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA I KOSOVËS (BSPK) I KANË BËRË THIRRJE QEVERISË PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR PAGA DUKE MARRË PARASYSH VËREJTJET E TYRE | FAQE 4-5

## SINDIKATAT, QEVERISË: NGA 2 PRILLI DO TË NDËRMARRIM VEPRIME SINDIKALE



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura i Kosovës (BSPK) i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndërmarrë hapa të nevojshëm dhe ta fillojë hartimin e Projektligjit për Paga. Këto dy sindikata kanë theksuar se një gjë e tillë është e nevojshme. Sipas tyre, qeveria duhet të merret seriozisht me kërkesat e punëtorëve

### AKTUALE



SCHOLZ KËRKON QË BE-JA T'I NISË BISEDIMET ME TIRANËN DHE SHKUPIN PËR ANËTARËSIM | F. 2

PEZULLOHET GREVA E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS NË PROKURORINË THEMELORE TË PRISHTINËS | F. 5

OSMANI NË DOHA: KOSOVA OFRON MUNDËSI INVESTIMI PËR BIZNESET NGA KATARI | F. 8

### EKONOMI



BAJRAMI, MURATIT: PUBLIKOJE LISTËN E TOP 50 PËRFITUESVE TË 230 MILIONË EUROVE | F. 8

ZJARRET PO DJEGIN EDHE ASETET ELEKTROENERGJETIKE | F. 8


### SPORT



SONTE MIQËSORJA VËLLAZËRORE ZVICËR - KOSOVË | F. 10

Në QKUK fillon punën Spitali  
Pediatrik-Kirurgjik

| FAQE 3



TAHIRI: E TURPSHME QË LV-ja NUK VOTOI KOMISIONIN HETIMOR PËR MENAXHIMIN E KRIZËS ENERGJETIKE

| FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zelensky këmbëngul në 'integritetin territorial' të Ukrainës para bisedimeve me Rusinë

KIEV, 28 MARS - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka insistuar në integritetin territorial të vendit të tij përpara bisedimeve me Rusinë në Turqi këtë javë.

Prioritetet e Ukrainës në bisedime do të jenë "sovrانيتeti dhe integriteti territorial", i tha Zelensky kombit të vet në fjalimin e tij të vonshëm më 27 mars.

Në një telefonatë me presidentin rus Vladimir Putin, më 27 mars, presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ra dakord të ishte

nikoqir i bisedimeve dhe bëri thirrje për një armëpushim dhe kushte më të mira humanitare, tha zyra e tij.

Inteligjenca ushtarake e Mbretërisë së Bashkuar tha më 28 mars se forcat ruse në Ukrainë nuk kanë bërë ndonjë përparim të rëndësishëm në 24 orët e fundit. Megjithatë, Rusia ka fituar më shumë terren në jug, në afërsi të Mariupolit, ndërsa po lufton për ta marrë portin, shtoi ai.

Kreu i inteligjencës ushtarake ukrainase, Kyrylo Budanov, akuzoi Rusinë se kërkon ta ndajë

Ukrainën në dysh, duke bërë krahasimin me Korenë e Veriut dhe atë të Jugut.

Një udhëheqës separatist në Luhansk tha më 27 mars se rajoni mund të organizojë së shpejti një referendum për bashkim me Rusinë.

Zelensky tha se qeveria e tij do ta shqyrtonte shpalljen e neutralitetit dhe ofrimin e garancive të sigurisë për Rusinë, duke përsëritur deklaratat e mëparshme. "Kjo do ta përfshinte mbajtjen e Ukrainës pa armë bërthamore", tha ai.



## Ukraina me ligj për kufizimin e shpërndarjes së informacioneve për ushtrinë



Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka nënshkruar ligjin që kufizon shpërndarjen e informacioneve lidhur me ushtrinë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që aktualisht është në fuqi. Kushdo që e shkel këtë ligj mund të dënohet deri me 12 vjet burgim.

Sipas dokumentit, ndalohet incizimi i lëvizjeve të personelit ushtarak, vendeve të granatimeve, emrat e rrugëve, ndalesat rrugore, dyqanet dhe fabrikat e tjera civile dhe

ushtarake.

Ligji, që është nënshkruar nga presidenti Zelensky gjatë fundjavës, po ashtu ndalon publikimin e të dhënave lidhur me lëvizjen e ndihmës ushtarake nga shtetet e huaja. Ky ligj nuk vlen për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm.

Ky njoftim vjen pas shqetësimeve se disa persona kanë postuar online informacione të ndjeshme lidhur me ushtrinë ukrainase.

Më 21 mars Shërbimi Sekret ukrainas ndaloi një person i cili kishte postuar në TikTok vendndodhjen e forcave të armatosura në Kiev. Pak kohë pas postimit të kësaj videoje, Rusia kreu një sulm me raketa në atë zonë, duke vrarë tetë persona.

Ky shërbim sekret ende po heton nëse personi që postoi informacione e ka bërë këtë qëllimisht, duke tentuar që të publikojë informacione sekrete në të mirë të Rusisë.

## G7 refuzon ta paguajë energjinë ruse me rubla

Ministri gjerman i Energjisë tha se grupi i shtatë vendeve më të industrializuara është pajtuar që ta refuzojë kërkesën e Rusisë që të paguajë me rubla për energjinë ruse.

Ministri Robert Habeck u tha gazetarëve të hënën se "të gjithë ministrat e G7-s janë pajtuar se pranimi i kësaj kërkesë do të ishte shkelje e kontratave ekzistuese".

Ai tha se pas një takimi online të ministrave të Energjisë të G7-s ata u pajtuan që "pagesa me rubla nuk është e pranueshme dhe ne u bëjmë thirrje të gjitha kompanive të prekura nga kërkesa [e presidentit rus,

Vladimir] Putin të mos e zbatojnë atë".

Ky njoftim vjen pasi Putini urdhëroi Bankën Qendrore ruse, qeverinë dhe Gazpromin që deri më 31 mars t'i paraqesin propozimet për pagesën e gazit me rubla ruse nga "shtetet jomiqësore", përfshirë të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian.

Më 28 mars Kremli tha se Rusia po punon për metodat e pagesave për eksportet e saj të gazit dhe do të ndërmarrë vendime karshi vendimit të evropianëve që po refuzojnë të bëjnë pagesa me monedhën kombëtare ruse. "Ne nuk do t'i furnizojmë falas me gaz,

kjo është e qartë", tha zëdhënësi i Kremelit, Dmitry Peskov.

Më 23 mars Putini njoftoi se Rusia do të zbatonte ndryshime dhe do të ndalonte së pranuari pagesa në valutat që "janë kompromentuar". Ky njoftim do të thotë se shtetet evropiane, që kanë vendosur sanksione ndaj Rusisë, përfshirë edhe Britaninë, Kanadanë, Zvicrën, Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara, duhet të paguajnë me rubla për gazin natyral rus.

Ndërkaq, më 25 mars, gjatë një takimi të liderëve të BE-së, nuk pati një qëndrim të përbashkët për këtë kërkesë të Rusisë.



## Scholz kërkon që BE-ja t'i nisë bisedimet për anëtarësim me Tiranën dhe Shkupin



BERLIN, 28 MARS - Bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut duhet të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur për shkak se vonesat në këtë drejtim do ta bëjnë Ballkanin Perëndimor të ndjeshëm ndaj ndikimit të jashtëm. Kështu deklaroi të hënën kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz. "Është e qartë edhe për Gjermaninë dhe Suedinë se

BE-ja duhet t'i shtyjë përpara reformat institucionale për ta bërë veten të aftë për zgjerim", tha Scholz në një konferencë për medie pas takimit me kryeministren suedeze Magdalena Andersson.

Nisja e bisedimeve për anëtarësim për Tiranën dhe Shkupin u bllokua në nëntor të vitit 2019, pasi Bullgaria, shtet anëtar i BE-së, vendosi veto ndaj anëtarësimit të

Maqedonisë së Veriut. Sofja kërkoj që fillimisht të arrihet një marrëveshjeje për gjuhën e identitetin maqedonas që, sipas Sofjes, kanë "rrënjë bullgare".

Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria kanë formuar grupe punuese, duke tentuar që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet, në mënyrë që Shkupi dhe Tirana të mund t'i nisin bisedimet për integrim evropian.



## BE-ja kërkon që të respektohet marrëveshja për integrimin e gjyqësorit

PRISHTINË, 28 MARS - Bashkimi Evropian ka bërë thirrje që të ulen tensionet dhe të respektohet marrëveshja për integrimin e personelit serb në sistemin gjyqësor të Kosovës, por edhe procedurat e rregullave disiplinore të Kosovës.

Ky reagim i BE-së vjen pasi javën e kaluar Këshilli Gjyqësor i Kosovës suspendoi nga puna kryetaren e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Lilana Stevanović. Kjo e fundit, më 22 mars, së bashku me përfaqësues të tjerë të serbëve të Kosovës, mori pjesë në një mbledhje në Beograd, të thirrur nga presidenti serb Aleksandër Vuçiq.

Zëdhënësi i BE-së për çështje të politikës së jashtme dhe siguri, Peter Stano, deklaroi për gazetaret se duhet të respekton procedurat, po ashtu të kuptohet rëndësia e integritetit të personelit serb në sistemin gjyqësor të Kosovës. "Kemi marrë në dijeni vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për suspendimin e përkohshëm të kryetares së Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Personeli serb i Kosovës ishte integruar në sistemin ligjor të Kosovës më 2017 përmes një marrëveshjeje të arritur në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Ky integrim

kishte mundësuar qasje në sistemin ligjor të Kosovës dhe sistemin e drejtësisë për komunitetin serb", ka thënë ai.

Stano shtoi se "personeli gjyqësor i integruar kryen detyra të rëndësishme nga të cilat përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë komunitetet joshumicë në Kosovë". "BE-ja pret që autoritetet kompetente të Kosovës, por edhe të Serbisë, t'i respektojnë të gjitha pjesët e kësaj marrëveshjeje", ka thënë Stano. "Procedurat disiplinore nuk janë pjesë e marrëveshjes. BE beson se autoritetet kompetente do ta ndjekin procesin dhe procedurën e duhur lidhur me shqyrtimin e një rasti të tillë disiplinor. Në të njëjtën kohë, presim nga personeli i sistemit ligjor të Kosovës të veprojnë në bazë të ligjeve dhe rregullave të Kosovës", ka theksuar ai.

Zëdhënësi i BE-së ka përsëritur edhe thirrjen e bllokut evropian për përmbajtje nga retorika nxitëse. "BE-ja fton Kosovën dhe Serbinë që të veprojnë me përmbajtje dhe të përmbahen nga retorika apo veprimet të cilat mund të nxitin tensione. Presim nga të dyja palët të veprojnë me përgjegjësi dhe të kontribuojnë për një atmosferë të përshtatshme për normalizimin e raporteve të tyre", ka deklaruar Stano.



Pas suspendimit të Lilana Stevanović, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, pas një proteste të mbajtur më 25 mars, ka njoftuar se kjo parti dhe stafi gjyqësor serb do ta pezullojnë punën deri në kthimin

në punë të Stevanovićit.

Pas suspendimit të Stevanovićit, presidenti serb Aleksandar Vuçiq akuzoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për shkelje të marrëveshjeve të arritura në Bruksel, dhe tha se Marrëveshja e

Brukselit e arritur më 2013 nuk ekziston më. Por, këto deklarata në BE nuk kanë dashur t'i komentojnë.

Ndërkaq, Kurti ka thënë se sistemi gjyqësor i Kosovës është i pavarur nga qeveria. (rel)

## Në QKUK fillon punën spitali pediatrik-kirurgjik



EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka filluar punën të hënën Spitali Pediatrik-Kirurgjik, donacion prej 22 milionë eurove i Emirateve të Bashkuara Arabe për shëndetësinë e Kosovës.

Në ditën e parë të funksionalizimit të këtij spitali janë kryer dy operacione të fëmijëve si dhe kanë filluar punën Ambulanca Specialistike për Fëmijë, Emergjenca Pediatrike dhe Kirurgjia Specialistike.

Brenda këtij spitali janë funksionalizuar shërbimet e hemato-onkologjisë pediatrike, të kirurgjisë pediatrike dhe shërbimet e mjekësisë interne për fëmijë, ndërkohë që pritet të transferohen edhe neonatologjia, shërbimet ortopedike dhe shërbimet e tjera për fëmijë. Spitali pediatrik-kirurgjik do t'i

integrojë shërbimet e emergjencave pediatrike mjekësore; ato të traumës; shërbimet e observimit dhe rikuperimit; shërbimet e ambulancave specialistike pediatrike dhe kirurgjike; Njësinë e Radiologjisë së Fëmijëve; sallat e operacioneve urgjente dhe të planifikuara; Njësinë e Kirurgjisë Ditore dhe Endoskopisë së Fëmijëve; sterilizimin qendror; mjekimin intensiv të fëmijëve dhe të porsalindurve; Departamentin e Kirurgjisë së Fëmijëve dhe Departamentin e Onkologjisë Pediatrike.

Spitali Pediatrik-Kirurgjik në QKUK pritet të shënojë një kthesë të rëndësishme sa i përket cilësisë së shërbimeve shëndetësore terciare që do t'u ofrohen fëmijëve në Kosovë, ndërsa MSh-ja ka falënderuar Emiratet e Bashkuara Arabe për këtë investim kapital dhe zemërgjerë për fëmijët e Kosovës.

## Kurti, vizitë zyrtare në Norvegji

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministren e Arsimit, të

Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit, Edona Maloku Bërdyna, dhe zëvendësministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, kanë udhëtuar për vizitë

zyrtare në Norvegji. Gjatë qëndrimit atje, kryeministri Kurti do të takohet me kryeministrin e Norvegjisë, Jonas Gahr Store, dhe me zyrtarë të tjerë të lartë të qeverisë norvegjeze.







SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E KULTURËS E KOSOVËS (SBASHK) DHE BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA (BSPK) I KANË BËRË THIRRJE QEVERISË PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR PAGA DUKE MARRË PARASYSH VËREJTJET E TYRE

# Sindikatat, qeverisë: Nga 2 prilli do të ndër marrim veprime sindikale

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPK) i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe ta fillojë hartimin e Projektligjit për Paga. Këto dy sindikata kanë theksuar se një gjë e tillë është e nevojshme. Sipas tyre, qeveria duhet të merret seriozisht me kërkesat e punëtorëve

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 28 MARS** - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) i ka bërë thirrje qeverisë për takim në lidhje me kërkesat e të punësuarve në sektorin e arsimit dhe të shumë institucioneve të kulturës për Projektligjin për Paga duke ua dërguar edhe propozimet konkrete për vërejtjet që kanë në draftin e publikuar si dhe tabelën e koeficienteve.

SBASHK-u u ka dërguar qeverisë dhe ministrive gjegjëse shkresa për Projektligjin për Paga. "Ua kemi adresuar shumë herë edhe kërkesën tonë modeste për një shtesë në pagë prej 100 eurosh për të gjithë të punësuarit në arsim e kulturë derisa të fillojë aplikimi i Ligjit të Pagave, kërkesë kjo e argumentuar nga ngritja e madhe dhe e vazhdueshme me çmimeve të artikujve elementarë. Kemi pritur se do të ndodhin takime

dhe dialog i mirëfilltë, por deri tani nuk ka ndodhur. Në përpjekje për të pasur takime dhe dialog, u kemi dërguar letra presidentes së Kosovës dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës që ta shfrytëzojnë pozitivisht autoritetin e tyre dhe të ndihmojnë që të ketë dialog frytdhënës", është thënë në reagimin e SBASHK-ut.

Sipas këtij institucioni, përmes këtij publikimi edhe një herë u bëjnë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrin Sveçla, ministres Nagavci dhe ministrin Murati që ta shfrytëzojnë edhe këtë javë për dialog, në të kundërtën, më 2 prill 2022, Kongresi i SBASHK-ut do të marrë vendime për veprime sindikale ashtu siç është deklaruar anëtarësia me shkrim.

Edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndërmarrë hapa të nevojshëm dhe ta fillojë hartimin e Projektligjit për Paga. "E thërësim partneren tonë sociale - qeverinë -

që të merret më këmbëngulshëm e më profesionalisht me hartimin e Projektligjit për Paga, duke i përfshirë edhe kapacitetet tona profesionale dhe të hapë rrugë për pagën minimale dhe për Kontratën Kolektive, për këto akte të rëndësishme e tejet të nevojshme juridike të cilat po tejzvarriten. Kjo tejzvarritje nuk është aspak e mirë, sidomos kur është premtuar dhe është bërë marrëveshja e është marrë zotimi. Na respektoni që të mund të kemi respekt të dyanshëm", është bërë me dije në reagimin e BSPK-së, duke theksuar se kërkesat e arsyeshme të punëtorëve meritojnë mirëqenie sociale ndryshe. "Në kohën kur lufta në Ukrainë po shtohet, e cila ka angazhuar vëmendjen e Fuqive të Mëdha, të ShBA-së, të NATO-s dhe të BE-së, dhe ka nxjerrë në dritë mendësinë mesjetare të fqinjit tonë i cili haptas po kërcënon lirinë dhe integritetin tonë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës thërret

partneren tonë sociale - qeverinë që, përveç kujdesit të tejshuar për ruajtjen e lirisë dhe të integritetit të vendit, të merret edhe me kërkesat e arsyeshme të punëtorëve dhe t'u dalë krahë, se vërtet kanë nevojë dhe meritojnë mirëqenie sociale ndryshe", është thënë në reagimin e BSPK-së.

Ish-kryeministri dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar të hënën në seancën e Kuvendit se "nuk është koha të flitet se kush është veteran i vërtetë i luftës e kush jo". Sipas tij, veteranët e UÇK-së duhet të përfshihen në Ligjin për Pagat. "E dimë që Ligji i Pagave është në proces, por mos të harrojmë të fillojmë nga kategoritë më meritore, ato të lirisë. Të paktën të përfshihen në këtë rritje e të mos i ofendojmë këta njerëz", është shprehur Haradinaj.

Ministria e Financave kishte propozuar që paga minimale të jetë 264 euro në muaj, por nuk është miratuar nga përfaqësuesit e sindikatave.

Përfaqësues të sektorit privat kanë propozuar që paga minimale të jetë jo më pak se 400 euro. Projektligji për Paga do të kthehet në pikën zero, pasi Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar

punën për hartimin nga e para të Projektligjit për Pagat.

Mediet para disa ditësh kanë publikuar vendimin e sekretares së përgjithshme të MPB-së, Fahrije Tërnavë-Sheremeti, për themelimin e ekipit punues. "Themelohet Ekipi Punues për hartimin e Draftit fillestar të Projekt-Ligjit për Pagat në sektorin publik", thuhet në pikën e parë të vendimit të datës 14 mars 2022.

Ky ekip përbëhet nga 34 persona dhe një ekspert i jashtëm, por sipas nevojës dhe në bazë të vlerësimit të udhëheqëses të ekipit punues, gjatë hartimit të draftit fillestar mund të ftohen edhe përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë të tjerë në këtë ekip.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, pasi ka parë këtë vendim, ka reaguar, duke theksuar se "kthimi në pikën zero i Projektligjit për Paga është mashtrimi tjetër i qeverisjes njëvjeçare dhe dëshmi për pazotësi dhe arrogancë mbi sektorin publik".

Tahiri ka thënë se parulla "Krejt dhe drejt" paska qenë slogan sa për t'i "kapur votat" dhe jo program politik e qeverisës, për ta mbrojtur të drejtën elementare të punëtorëve për një pagë të dinjitetshme.



# Pezullohet greva e punonjësve të administratës në Prokurorinë Themelore të Prishtinës

Prishtinë, 28 mars (ER) - Këshilli Grevist i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka njoftuar se pas takimeve të mbajtura me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), janë marrë vesh të pezullohet greva

njmujore dhe t'u jepet hapësirë institucioneve kompetente për realizimin e kërkesave legjitime të punonjësve të administratës në një afat të arsyeshëm kohor. Këshilli Grevist i kësaj prokurorie

përmes një njoftimi ka shprehur vendosmërinë se nuk do të heqin dorë deri në realizimin e kërkesave të tyre, njëherësh ka shprehur konsideratë për gatishmërinë dhe përkushtimin e KPK-së dhe të

SKPK-së për t'i mbështetur kërkesat e punonjësve të administratës nga dita e parë e fillimit të grevës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) para një jave njoftuar se është pezulluar greva e punonjësve të

administratës në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e vendit, por në praktikë nuk kishte ndodhur diçka e tillë. Prokuroria Themelore e Prishtinës kishte vazhduar grevën deri më 28 mars.



## Dy të vdekur dhe 16 raste të reja me Covid



PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, informon se prej 830 testeve, 16 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes. Të hënën janë shëruar 76 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 648. Në total numri i rasteve aktive është 597. Pesë pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë po trajtohen në

Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës. Në trajtim janë edhe tetë pacientë post Covid. Me oksigjenoterapi janë gjashtë pacientë, kurse në Mjekim Intensiv po trajtohen dy pacientë. Në 24 orët e fundit janë dhënë 15 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 821 268 doza të vaksinës. Deri më sot 820 020 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 99 787 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



## Krasniqi në Izbicë: 23 vjet pas luftës, Kosova ende pret drejtësi për krimet mizore të Serbisë

SKENDERAJ, 28 MARS (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka qëndruar të hënën në Izbicë, ku ka bërë homazhe në 23-vjetorin e masakrës së Izbicës. Përmes një postimi në "Facebook", Krasniqi është shprehur se kjo masakër është vetëm një nga dëshmitë e gjenocidit serb në mesin e mbi 400 masakrave anekënd Kosovës. "Më 28 mars 1999 në Izbicë koha u

ndal. Vdekja mbuloi fshatin. Ushtarët, policët dhe paramilitarët serbë nuk kursyen askënd. Nga më të vegjlit e deri te më të moshuarit, 147 civilë të paarmatosur e të pafajshëm u kthyen në cak të një prej krimeve e masakrave më makabre që u kryen gjatë luftës në Kosovë. Në mesin e tyre ishte edhe Dafina, ende pa i mbushur 6 muaj, trupi i së cilës u gjet 18 vjet pas vrasjes në

varrezën masive të Petrovo Selos në Serbi", ka shkruar Krasniqi. Lideri i PDK-së thotë se edhe sot, 23 vjet pas luftës, familjet e martirëve, Izbica, Skenderaj, dhe tërë Kosova, presin ende drejtësi për këtë krim mizor. "Drejtësinë do ta kërkojmë përjetësisht - ashtu siç përjetësisht do të jetojmë me kujtimin dhe nderimin e martirëve tanë. Lavdi, sot e përgjithmonë!", ka shkruar Krasniqi.



## Totaj takohet me zëvendësministrin e Industrisë së Turqisë, flasin për investime në Prizren

PRIZREN, 28 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim zëvendësministrin e Industrisë dhe Teknologjisë në Republikën e Turqisë, Çetin Ali Donmez, i cili ishte i shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar dhe bashkëpunëtorë. "Biseduam për nxitjen e investimeve nga investitorët turq në Prizren dhe për rritjen e bashkëpunimit mes nesh, po ashtu u pajtuam të ndërveprojmë me ambasadën për t'i rritur kapacitetet profesionale në përputhshmëri me nevojat e tregut", ka thënë Totaj. Ai ka theksuar se Turqia përherë ka qenë përkrah Kosovës, e cila ka mbështetur dhe vazhdon ta ndihmojë në zhvillimin e sektorëve të ndryshme siç janë edukimi, shëndetësia dhe ekonomia.

## Ramosaj përkujton dëshmorët e demonstratave të vitit 1989

DEÇAN, 28 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka përkujtuar dëshmorët Ismet Qorraj, Sali Hadergjonaj, Mujë Mehmeti dhe Agim Kukleci të cilët janë vrarë në demonstratat e 28 marsit të vitit 1989. Ramosaj ka thënë se po atë ditë u plagosën qindra njerëz dhe shumë demonstrues. "Sot nderojmë dhe përkujtojmë me respekt 28 marsin e vitit 1989, ku nën demonstratat e organizuara

në mbrojtje të identitetit tonë, ranë dëshmorë Ismet Qorraj, Sali Hadergjonaj, Mujë Mehmeti dhe Agim Kukleci. Po atë ditë u plagosën qindra njerëz dhe shumë demonstrues. Kujtojmë lavdinë e betejës tek 'Ura e Pozharit', ku ranë dëshmorë Elez Geci dhe Maxhun Berisha. Lavdi e përjetshme për të gjithë dëshmorët e rënë për liri!", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Komuna e Mitrovicës vazhdon t'u shqiptojë gjoba ndotësve të ambientit



MITROVICË, 28 MARS (ER) - Inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, po vazhdojnë zhvillimin e aksioneve të përbashkëta në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve. Kështu, në zbatim të Udhëzuesit Administrativ /2018 për ndëshkimet me gjoba mandatore për mbrojtjen e

mjedisit dhe shëndetin e njeriut nga mbeturinat, Drejtoria e Inspeksionit ka shqiptuar gjoba për qytetarët që ndotin ambientin. Inspektorët e sektorit të shërbimeve komunale kanë dënuar një qytetar të Mitrovicës me gjobë në vlerë prej 100 eurosh si pajojë e ndotjes së

ambientit dhe hedhjes së mbeturinave në sipërfaqe publike. Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Valon Brahimi, ka bërë me dije se përmes këtyre aksioneve synohet parandalimi i hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara si dhe vetëdijesimi i qytetarëve në ruajtje të mjedisit.



## Osmani për masakrën e Izbicës: Do të bëjmë çmos që drejtësia të vihet në vend

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar 23-vjetorin e masakrës ndaj 16 anëtarëve të familjeve Bogujevci, Duriqi, Llugaliu dhe Selman Gashit në Podujevë si dhe masakrës së rreth 150 personave në Izbicë të Skenderajt. Osmani ka thënë se do të bëhet çmos që drejtësia të vihet në vend për secilin njeri tonin të vrarë. "Shtatë fëmijë të moshës 2 deri 15 vjeç dhe shtatë gra të familjeve Bogujevci e Duriqi, dy anëtarë të familjes Llugaliu dhe Selman Gashi, 23 vjet më

parë janë ekzekutuar mizorisht nga forcat e regjimit gjencidal të Serbisë. Kjo dëshmon qartë strategjinë e organizuar shtetërore të regjimit kriminal serb kundrejt shqiptarëve pa dallim moshe. Këtë e dëshmon më se miri edhe masakra e të njëjtës ditë në Izbicë, ku u ekzekutuan afro 150 djem, burra e pleq. Do të bëjmë çmos që drejtësia të vihet në vend për secilin njeri tonin të vrarë, sepse vetëm kësajsoj do t'u dalim hakut vetë atyre, por edhe të

mbijetuarve. Atëherë do të ketë kuptim liria dhe pavarësia jonë", ka deklaruar Osmani. Ajo shtoi se nga masakra në Podujevë janë pesë të mbijetuar. "Saranda, Fatosi, Jehona, Liria dhe Genc Bogujevci janë dëshmia autentike e krimit monstruoz. Do t'i kujtojmë gjithmonë familjarët e tyre, të vrarët në Izbicë dhe kudo në Kosovë, sepse vetëm duke e memorizuar këtë pjesë të historisë do ta shohim më qartë rrugën që e kemi përpara", ka theksuar Osmani.



## Tahiri: E turpshme që LV-ja nuk votoi Komisionin Hetimor për Menaxhimin e Krizës Energjetike

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Vetëm 23 vota ka marrë formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për Menaxhimin e Krizës Energjetike, që ishte iniciativë e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Për themelimin e këtij komisioni votuan deputetët e opozitës, ndonëse nuk ishin të gjithë të pranishëm, ndërkaq kundër votuan deputetët të Lëvizjes Vetëvendosje.

Pas dështimit të kësaj iniciative shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilën i ka kritikuar deputetët e mazhorancës për votimin kundër themelimit të një komisioni hetimor parlamentar për krizën energjetike, për çka GP i PDK-së e ka lëshuar seancën plenare.

Tahiri në një konferencë për medie tha se që dy dekada prej se është themeluar Kuvendi i Kosovës kjo është hera e parë që një parti politike bllokoi themelimin e një komisioni hetimor. "Asnjëherë në të kaluarën asnjë grup parlamentar nuk ka ndodhur që të refuzojë të hedhim dritë mbi çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm që ka mundur të ndodhë nga cilido



institucion, kushdo qoftë ai. Republika e Kosovës ka një histori sa iu përket hetimeve parlamentare. Hetimi

parlamentar është një instrument i opozitës i rregulluar me ligj", ka thënë ai.

Tahiri ka theksuar se për

formimin e komisionit hetimor parlamentar për krizën energjetike paraprakisht ka pasur një pajtim mes grupeve

parlamentare që të propozohen emrat dhe pastaj të vazhdohet më tutje në Kuvend. "Sot edhe ashtu kërkova që të mos kemi debat për këtë çështje, por të votohet komisioni dhe pastaj ai të hedhë dritë mbi të gjitha dyshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar afër 200 milionë euro nga taksat e qytetarëve dhe pikërisht kërkesa jonë dhe e partive të tjera opozitare ishte që të hidhet dritë mbi shpenzimin e këtyre taksave, se si janë menaxhuar, ku kanë shkuar, kush ka përfituar nga to, kush kanë qenë kompanitë të cilat kanë blerë rrymë në emër të Republikës së Kosovës", ka thënë Tahiri.

Ai ka paralajmëruar se PDK-ja se do ta iniciojë themelimin e një komisioni hetimor parlamentar përmes formave të tjera, që të hedhë në dritë në të gjitha keqpërdorimet që janë bërë gjatë krizës energjetike. "Sot qeveria Kurti ka hapur një debat për një aferë shumë të madhe korruptive, të cilën sot u mundua me vota ta ndalë, mirëpo opozita ka edhe instrumente të tjera për krijimin e këtij komisioni. Siç e dini, ligji parlamentar i lejon opozitës të themelojë një komision të tillë me 40 nënshkrime", ka deklaruar Tahiri.

## Rruga Prishtinë - Podujevë u keqpërdor nga qeveria

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - "Premtimet për punimet në rrugën Prishtinë - Podujevë u përdorën nga qeveria vetëm për përfitime elektorale", ka thënë shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri.

Në seancën e Kuvendit mbajtur të hënën, ai ka kërkuar sqarime nga ministri i Infrastrukturës lidhur me zvarritjen e punimeve të rrugës Podujevë - Prishtinë. "Më 11 gusht të vitit 2021 ministri

dhe zëvendësministri kanë dalë në fushatë zgjedhore dhe kanë thënë se rruga Prishtinë - Podujevë kryhet deri në fund të vitit 2021. Tash është muaji i katërt i vitit 2022, respektivisht muaji i gjashtë prej kur kanë premtuar në fushatë zgjedhore e se kanë vendosur asnjë guri në atë rrugë. Përndryshe kryeministri Kurti bënte be 'pasha Kurani' kemi për ta ndërtuar Podujevën, pyetja ime për ministrin Liburn

Aliu është se a ka qenë premtim elektorale, për të marrë vota në Podujevë, apo po zotoheni se do ta përfundoni atë rrugë. Nëse e keni zotim, ju lutem silleni në Kuvend rirregullimin buxhetor, ngaqë kjo rrugë është arterie kryesore dhe më e dendur në trafik. Ju lutem silleni rirregullimin buxhetor për këtë rrugë të cilin jua votojmë e mos u arsyetoni se s'keni buxhet dhe mundësi", ka thënë Tahiri.





## Bajrami, Muratit: Publikojë listën e top 50 përfituesve të 230 milionë eurove

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 28 MARS** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, gjatë seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, e cila është mbajtur të hënën, ka deklaruar se për tejkalimin e krizës së rritjes së çmimeve në tre muajt e fundit janë ndarë 230 milionë euro.

Murati gjatë seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, po ashtu, ka njoftuar se fondet e Zyrës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) janë riorientuar. "Fondet e MCC-së nuk kanë humbur, përkundrazi kemi rifilluar negociimin. Këto fonde janë riorientuar me kapacitete akumuluese të energjisë elektrike që është më tepër për agjendën e gjelbër dhe, në anën tjetër, për ngritjen e burimeve njerëzore", ka thënë Murati. Ai ka shtuar se rritja e çmimeve në import dhe manipulimet e mundshme të tregtarëve janë dy faktorët për rritjen e kostos së shportës së qytetarëve. "Sa i përket rritjes së çmimeve janë dy faktorë: Rritja e çmimeve në import, që është fenomen botëror, jashtë çdo kontrolli të çfarëdo qeverie dhe, e dyta, është nga manipulimet që mund të bëhen në emër të këtij inflacioni nga tregtarët", ka



thënë Murati.

I pari i financave ka përmendur disa nga vlerat që Qeveria e Kosovës ka ndarë për tejkalimin e krizës ekonomike në vend. "Deri më tani kemi marrë disa masa. Pikë së pari subvencionimi i rrymës që mos të ketë rritje të çmimit për prodhuesit dhe amvisëritë që konsumojnë nën 800 kWh. Janë 45 milionë euro për subvencionimin e familjeve dhe janë 25 milionë euro shtesë

që shkojnë për pensionistët për këtë vit. Janë 10 milionë euro për subvencionimin e skemave të asistencës sociale, gjithashtu janë 10 milionë euro për rritjen e rezervave shtetërore. Po ashtu, janë rreth 20 milionë euro për t'i shtuar subvencionet në bujqësi. Pra, gjithsej janë 230 milionë euro në tre-katër muajt e fundit për t'i mbështetur qytetarët karshi rritjes së çmimeve", ka përfunduar Murati.

Deklarata e Muratit, se janë ndarë 230 milionë euro, nuk ka kaluar pa u diskutuar në Kuvend. Ka qenë deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, e cila ka thënë se qeveria Kurti nuk ka guximin t'i publikojë listat se kë e ka subvencionuar. Madje, pas kësaj, Bajrami ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", duke i kërkuar Muratit ta publikojë listën e top 50 përfituesve të 230 milionë eurove. "E sfidoj

ministrin Murati që ta publikojë listën e 50 top përfituesve të këtyre 230 milionë eurove. Çdo taksapagues i këtij vendi ka të drejtë të dijë kush ka përfituar në vitin 2021 prej 230 milionë eurove të ndara nga qeveria. Bizneset jo! Bujqit jo! Qeveria po thotë qytetarët. Le të tregojë kush janë përfituesit. Ne nuk po e dimë. Qeveria e di dhe duhet të tregojë!", ka shkruar Bajrami.



## Osmani në Doha: Kosova ofron mundësi investimi për bizneset nga Katari



**PRISHTINË, 28 MARS (ER)** - Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se inkurajon afaristët dhe bizneset e Katarit që t'i eksplorojnë mundësitë e investimit që ofron Kosova. Këtë deklaratë Osmani e ka bërë gjatë një takimi me kryetarin e Odës Ekonomike të Katarit, Khalifa bin Jassim al-Thani, të mbajtur në margjinat e Forumit në Doha.

Në takim, gjithashtu, janë diskutuar marrëdhëniet dypalëshe në nivel tregtar dhe mjetet për t'i përmirësuar ato. Osmani ka vlerësuar marrëdhëniet mes dy vendeve, duke theksuar se mezi pret që këto t'i çojnë në nivele më të larta, veçanërisht në aspektin komercial dhe investues. Ajo

ftoi biznesmenët e Katarit t'i eksplorojnë mundësitë për investime në sektorë të ndryshëm, si bujqësia, miniera dhe energjia.

Ndërsa Al-Thani vlerësoi marrëdhëniet e mira në mes të Katarit dhe Kosovës, duke theksuar se marrëdhëniet tregtare janë ende nën aspiratat e të dy vendeve mike. Ai u bëri thirrje biznesmenëve të të dy vendeve që ta rritin bashkëpunimin.

Në fund ai ka theksuar se Oda Ekonomike e Katarit mbështet fuqishëm bashkëpunimin midis sektorëve të biznesit në të dy vendet. "Investitorët nga Katar janë të interesuar të njihen me mundësitë që ka Kosova", ka përfunduar ai.


## Zjarret po djegin edhe asetet elektroenergjetike

**PRISHTINË, 28 MARS (ER)** - Gjatë fundjavës në Kosovë ka pasur një numër të konsiderueshëm të zjarreve anekënd vendit, ka njoftuar KEDS-i. Këto zjarre kanë shkaktuar edhe djegien e asetëve elektroenergjetike në

disa raste në komuna të ndryshme të Kosovës. "Kjo situatë është e papranueshme, pasi përveç dëmtimit të asetëve, po ndikon direkt në ndërprerjen e energjisë elektrike për

mijëra konsumatorë. Ekipet tona kanë qenë vazhdimisht në vatrë të zjarreve ku janë afektuar asetet e KEDS-it dhe kanë bërë maksimumin që dëmet të jenë sa më të vogla. Apelojmë te të gjithë që të

kenë kujdes në rastet e zjarreve, sidomos atyre të qëllimshme, pasi po shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale, riparimi i tyre po merr kohë, ndërsa edhe konsumatorët po



mbesin kohë të gjatë pa energji elektrike", ka njoftuar KEDS-i.



INTERVISTË ME MARK GALEOTTI,

# “Për Putinin, ora më e vështirë. Por herët të flitet për grusht shteti”



“Kjo është koha më e vështirë për Vladimir Putin. Dhe vetëm mund të përkeqësohet”. Mark Galeotti, me origjinë italiane, është një nga ekspertët kryesorë për Rusinë në Mbretërinë e Bashkuar: profesor nderi në University College London, anëtar i institutit më të vjetër dhe prestigjioz britanik të mbrojtjes “Rusi”, drejtor i agjencisë së konsulencës Mayak Intelligence, Galeotti është gjithashtu autor i librave “Rusia e Putinit”, “Gorbaçovi dhe Revolucioni i tij” dhe “Axhenda e Kremlinit”.

**Profesor Galeotti, Biden thotë se Putini duhet të largohet. Sa pranë rrëzimit është në të vërtetë lideri rus?**

“Situata është e qëndrueshme, por e brishtë. Ka shenja nga më të ndryshmet: thuhet se ministri i Mbrojtjes Shoigu pësoi “infarkt”, dy anëtarë të rëndësishëm të FSB-së (ish-KGB) u arrestuan, u ndalua edhe numri dy i Gardës Kombëtare, mburoja e vërtetë kundër një kryengritjeje të mundshme popullore. Megjithatë, ka një rreth magjik përreth Putinit që është ende shumë solid, jashtëzakonisht i varur prej tij dhe me të cilin ai ndan të njëjtin vizion paranojak, ekstrem dhe konspirativ të botës. Nga ana tjetër, “teknokratët” e qeverisë janë shumë më të irrituar. Por ata kanë pak fuqi. Ekspozimi kundër Putinit është ende i rrezikshëm.

Shumë në Moskë duan ta heqin qafe atë, por shpresojnë që dikush tjetër ta bëjë.

**Çfarë mund ta përshpejtojë rënien e Putinit?**

“Sigurisht, një ecuri edhe më katastrofike se lufta në Ukrainë. Në këtë kuptim, sanksione të mëtejshme kundër Moskës do të ishin të dobishme: papunësia në Rusi është tashmë e lartë dhe ushtria është duke e humbur tashmë integritetin funksional. Shumë ushtarë janë të zemëruar, janë dërguar në vijën e frontit pa stërvitje, pa furnizime, ka zëra për kryengritje në Kiev. Do të jetë shumë interesante të shihet se çfarë do të ndodhë në prill kur të kenë thirrjen e re të detyrueshme ushtarake në Rusi: shumë dezertime janë të mundshme. Prandaj, nuk shoh se si gjërat mund të mos përkeqësohen për

Putinin.

**Pra, një grusht shteti është afër?**

Ende jo. Në Rusi, siç ndodhi kundër Hrushovit dhe Gorbaçovit, ka nevojë për koordinimin e elitës politike, ushtrisë dhe KGB-FSB-së, gjë që nuk e shoh për momentin. Sistemi i sigurisë është aq i ndërthurur sa që një agjenci e vetme nuk mund ta rrëzojë presidentin. Por vetë FSB mendohet se ka sektorë gjithnjë e më të devijuar. Sipas mendimit tim, megjithatë, FSB është ende shumë besnik ndaj Putinit. Sidoqoftë, shumë zëvendës të drejtorit Bortnikov janë të rinj, vijnë nga një brez tjetër, kanë pikëpamje të tjera. Me ta, shumë gjëra mund të ndryshojnë.

Flitet shumë për ministrin e Mbrojtjes Shoigu, pasardhësin e

mundshëm të Putinit. Ka nga ata që e konsiderojnë si një skifter edhe më të ashpër.

Në realitet, ministri i Mbrojtjes është vërtet një patriot dhe nacionalist, por është gjithashtu më i ri dhe më pak fanatik se pjesa tjetër e nomenklaturës Putiniane. Shoigu nuk mendon se Perëndimi e urren thellësisht Rusinë. Thuhet se, përtej thashethemeve të shumta ai nuk u paraqit ditët e fundit sepse u “dënuua” nga Putini për rrjedhën e keqe të luftës në Ukrainë. Në realitet mund të jetë se ai ishte që është tërhequr.

**Pse?**

Ndoshta ai nuk dëshiron të ekspozohet ndaj një konflikti kaq katastrofik. Ose ai nuk dëshiron të njollojë imazhin e tij për arsye që ne nuk i dimë. Por nëse gjërat do të shkonin aq keq sa Putini të rrëzohej, kush do të vinte në pushtet?

Teorikisht kryeministri Mikhail Mishustin, por ai nuk ka as karizmën dhe as kalibrin. Rikthimi i ish-kryeministrit Medvedev? E vështirë. Deri vonë mendoja Shoigu, por jo më. Për pjesën tjetër, ka shumë kandidatë, por nuk më duket se aparatet e ndryshme të pushtetit rus konvergojnë në një figurë të vetme.

**Po i dërguari rus për klimën Chubais që iku jashtë vendit? Çfarë roli mund të luajë?**

Minimal apo të parëndësishëm, si të mërguarit e tjerë, shih Mikhail Khodorkovskij. Chubais është shumë i lidhur me oligarkët, por jo me klasën e mesme, ku diskreditohet sepse lidhet me privatizimet e egra të viteve 1990. Nëse “burri i fortë” Putin bie, a mund të zhytet Rusia në kaos total si Libia, me rrethanën rënduese të të qenit një fuqi bërthamore?

Jo. Megjithatë, Rusia mbetet një vend me struktura solide politike dhe institucionale. As nuk do të bëhet si Koreja e Veriut: është qendrore për ekonominë, ekuilibrin dhe tregtinë globale.

**A do të jetë i kënaqur Putini me një kalim mes Donbasit dhe Krimesë për të shpërbërë Ukrainën?**

Nuk e besoj. Tani rusët thonë se duan të përqendrohen në Lindje, por vetëm sepse taktikat e agresionit total në disa fronte në Ukrainë janë vërtetuar tmerrësisht të gabuara. Megjithatë, Putini me siguri nuk do të jetë i kënaqur. Ai gjithmonë i shtyn kufijtë. Kështu ka bërë gjithmonë.

*La Repubblica – Bota.al*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Sonte miqësorja vëllazërore Zvicër - Kosovë

Kosova e nisi për mrekulli vitin 2022 duke shënuar fitore me rezultat të thellë ndaj Burkina Fasos (5-0). Sonte "dardanët" me tifozët e shumtë në krahë do të kenë një test tjetër ndaj Zvicrës ku luajnë tre futbollistë shqiptarë. Xherdan Shaqiri e ka vlerësuar emocionuese dhe historike përballjen Zvicër - Kosovë, kurse ka paralajmëruar se vendasit synojnë fitore ndaj "dardanëve"



Futbollisti shqiptar që mbron ngjyrat e Zvicrës, Xherdan Shaqiri, ka thënë se do të jetë ndeshje emocionale përballja me Kosovën "Unë përgatitem për këtë ndeshje normalisht. Kam pasur ndeshje të tjera që ishin shumë më të rëndësishme se kaq. E rëndësishme është që të tregojmë një paraqitje të mirë dhe të reagojmë pas disfatës ndaj Anglisë. Sigurisht se do të jetë pak emocionale, por në përgjithësi ndihem mirë dhe kështu do të përpiqem të jem edhe në fushë", ka thënë Shaqiri.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 28 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të dielën zhvilloi stërvitjen e fundit në Kosovë, ndërsa të hënën udhëtoi drejt Cyrihut. Atje është pritur nga një numër i madh i bashkatdhetarëve.

Sonte (e martë) Kosova e kërkon fitoren e dytë në vitin 2022 në krye me përzgjedhësin Alain Giresse. Ky i fundit e ka vlerësuar miqësoren ndaj Zvicrës të veçantë për tifozët e Kosovës, kurse ka paralajmëruar se "dardanët" do ta zhvillojnë një tjetër ndeshje të bukur. "Do të

jetë shumë e rëndësishme të ketë tifozët të Kosovës në Cyrih. Është e rrallë që një ekip mysafir të luajë në praninë e kaq shumë tifozëve të vet. Shpresoj që do t'u ofrojmë kënaqësi tifozëve dhe Kosova të luajë një ndeshje të bukur. Të gjithë lojtarët janë të gatshëm të luajnë. Nuk kemi lëndime pas ndeshjes me Burkina Fason", ka thënë Giresse.

Ndërsa mbrojtësi Betim Fazliji, i cili është rritur si futbollist në Zvicër, ka thënë se do të jetë një ndeshje e fortë, por edhe një festë futbollit. Pavarësisht prej kualitetit të lartë të zvicëranëve, Fazliji

paralajmëron se Kosova luan për fitore. "Kundër Zvicrës na pret një ndeshje shumë e fortë. Do të ketë shumë shqiptarë në stadium dhe pa dyshim do të jetë një ndeshje shumë e veçantë. Kjo ndeshje do të jetë një festë futbollit. Ne do ta japim maksimumin dhe udhëtojmë për të fituar. Jemi disa lojtarë që jemi rritur në Zvicër dhe për mua është një ndeshje speciale. Dua të

fitojmë për të treguar çfarë potenciali ka Kosova dhe çfarë ekipi jemi. Presim nga 'dardanët' të na mbështesin edhe kundër Zvicrës ashtu sikurse ndaj Burkina Fasos. Duam t'i gëzojmë me lojë të mirë", ka thënë Fazliji. Futbollistët "dardanë" e kanë zhvilluar edhe stërvitjen e fundit në Zvicër para ndeshjes që zhvillohet sot (e martë) nga ora 18:00.

## Shqipëria pret Gjeorgjinë, Reja paralajmëron fitore

**TIRANË, 28 MARS** - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll do ta presë Gjeorgjinë në "Air Albania" të martën në orën 18:00 për ta zhvilluar miqësoren e dytë, pas asaj që kuqezinjtë zhvilluan me Spanjën. Në konferencën për shtyp për të folur për këtë takim ishte trajneri i kombëtares, Edi Reja, i cili ka thënë se Gjeorgjia është kundërshtarë e vështirë dhe se mbrohet mirë. Trajneri kuqezi ka paralajmëruar se pret ndeshje të mirë nga futbollistët kuqezi. "Sigurisht që Gjeorgjia është një kundërshtarë krejt ndryshe, por kemi parasysh që është një skuadër që mbrohet



mirë, vrapon shumë dhe është e rrezikshme në kundërsulm. E rëndësishme për ne është t'i shfrytëzojmë karakteristikat e

lojtarëve që kemi dhe ta marrim maksimumin. Është shumë e rëndësishme të bëjmë një ndeshje teknikisht të

përkryer, të jemi shumë të përqendruar në fushë, të bëjmë sa më pak gabime dhe të shfrytëzojmë sa më shumë raste dhe hapësirat që mund të na lërë Gjeorgjia në çaste të ndryshme të lojës", ka thënë Reja. "Djemtë tashmë e dinë dhe janë të qartë për mënyrën se si duhet ta interpretojnë këtë ndeshje dhe se si duhet të luajnë. Gjithsesi Spanja është i vetmi ekip në botë që ka këtë filozofi loje, një ekip që mund ta prekë topin për 50 herë dhe ti nuk e sheh fare. Gjeorgjia është ndryshe nga Spanja, por nuk është aspak një rivale më e dobët. Është një ekip i mirë dhe duhet të bëjmë një

ndeshje të kujdesshme. Gjeorgjia ka pikat e forta dhe të dobëta, por për ne është e rëndësishme që të shfrytëzojmë çdo moment dhe të finalizojmë sa më mirë momentet që na paraqiten", ka shtuar Reja, i cili më pas ka shtuar se ndeshjet miqësore për të kanë rëndësi të madhe. "Për mua miqësoret janë si ndeshje zyrtare, janë po aq të rëndësishme. Shoh te djemtë një motivacion shumë të madh dhe nuk kam aspak frikë në këtë aspekt. Jam i kënaqur me lojën dhe besoj se do të shikoni një ndeshje shumë të mirë nga ana e Shqipërisë ndaj Gjeorgjisë", ka deklaruar Reja.

## 'Blick': 'Zvicëranët' e Kosovës të entuziazmuar për duelin vëllazëror ndaj Zvicrës

**CYRIH, 28 MARS** - Janë lindur në Zvicër, por luajnë me Kosovën kundër Zvicrës. Mbrojtësit e Zurichut, Fidan Aliti dhe Mirlind Kryeziu, të martën do të luajnë për Kosovën kundër Zvicrës, në stadiumin Letzigrund, në shtëpi, kundër vendit ku kanë

lindur dhe janë rritur prindërit e tyre, shkruan "Blick". "Kur vendosa të luaj për Kosovën pas gjashtë vjetësh te grupmoshat e reja të Zvicrës, e dija se në një çast do të vijë një ndeshje ndaj Zvicrës. Jam i lumtur. Do të jetë një atmosferë fantastike në

Letzigrund", ka deklaruar Mirlind Kryeziu.

Ndërkaq Aliti thotë: "Është, gjithashtu, një ndeshje e madhe pasi Zvicra ka shumë cilësi. Kam marrë shumë kërkesa për bileta. Mund ta mbushja vetë një tribunë".





## Ibra: 'Topi i Artë' është çmim politik

MILANO, 28 MARS - Sulmuesi i Milanit, Zlatan Ibrahimović, për "Topin e Artë" mendon se është çmim politik. "Topi i Artë" është çmimi më i madh për lojtarët në aspektin personal, por në lidhje

me këtë çmim Ibrahimović ka dyshime. Në një intervistë për gazetën gjermane "Bild", ai ka thënë se është çmim politik. "Është një çmim politik. Ata duan 'zotërinë e përsosur'". Ishin

fjalët e Ibras në lidhje me "Topin e Artë". Sipas tij, fakti që nuk e ka fituar asnjëherë këtë çmim nuk e bën as lojtar më të mirë apo më të keq. "Nuk ndryshon asgjë, nuk më bën më të mirë apo më të

keq", ka shtuar ai. Ibrahimović asnjëherë nuk është zgjedhur fitues i "Topit të Artë", gjithashtu nuk ka qenë as në mesin e tre lojtarëve më të mirë të sezonit ndër vite.



## Gjimshiti: Ndaj Gjeorgjisë do të jetë një ndeshje ndryshe

TI RANË, 28 MARS - Për Berat Gjimeshin ndeshja miqësore që do të luhet ndaj Gjeorgjisë këtë të martë në orën 19:45 në "Air Albania" do të jetë shumë ndryshe nga ajo ndaj Spanjës, pasi kualiteti i lojtarëve nuk është i njëjti. Duke folur në konferencën për medie nga Barcelona në prag të këtij takimi, mbrojtësi i Kombëtares theksoi se humbja ndaj Spanjës ndodhi për shkak të humbjes së përqendrimit në minutat e fundit. Gjimeshi ka thënë se ajo çfarë ndodhi në miqësore nuk u ndikua aspak nga frika pasi, sipas tij, të luash përballë Spanjës është kënaqësi me vete.



**Humbja në minutat e fundit:** Sigurisht besoj kur ta kesh rezultatin në dorë në fund nuk ka nevojë për shumë teknikë, por për përqendrim që të mos bësh gabime dhe që të mos e pësosh në fund. Pas ndeshjes u mërzuam të gjithë por, siç thashë, është përqendrimi, një ndeshje luhet më shumë se 90 minuta dhe përqendrimi duhet të jetë në maksimum, sidomos me skuadrat e mëdha si Spanja që me një gabim e pëson. Duhet të mos rrezikosh në fund, pasi gabimi penalizohet menjëherë.

**Ndikimi psikologjik nga kjo humbje:** Kemi zhgënjim, menjëherë pas ndeshjes të gjithë ishim të mërzuar, pasi ishte një moment historik, pasi ta merrje

barazimin në Spanjë do të ishte gjë e bukur, më pas ishim të mërzuar, por më pas duhet të mësosh nga gabimet e të ecësh para, pastaj ditën tjetër gjërat shihen me sy ndryshe, pasi sheh gabimet, por sheh edhe çfarë ke bërë mirë.

**Ndikoi frika:** Unë mund të flas për veten më shumë se për të tjerët si janë ndierë, por nuk besoj se ka rol frika në këto ndeshje pasi i shijon 100%, sidomos kur ke rezultatin në dorë, ndikon përqendrimi, pasi të gjitha gjërat që i bën në 90 minuta, në tre minutat e fundit duhet të kesh kujdes.

**Mendonit se do të pësonit më keq ndaj Spanjës?:** Çdo futbollist që hyn në fushë nuk mendoj se hyn dhe beson se do të mundet 4-0. Çdo futbollist që hyn në fushë jep

më të mirën, pastaj ka të bëjë me fatin, përqendrimin.

**Qëndrimi në mbrojtje:** Përvojë italiane, nuk e di për çfarë e ke fjalën. Në klubin tim nuk luaj ashtu, të gjithë mbrapa dhe topa të gjatë, besoj se edhe të tjerët nuk janë mësuar të luajnë ashtu futboll, se futbollit po ecën përpara, por në minutat e fundit duhet të mbrohesh.

**Ndeshja me Gjeorgjinë:** Besoj se me ndeshjen që bëmë kundër Spanjës tifozët e kanë parë që dhamë gjithçka në fushë, por me Gjeorgjinë do të jetë një ndeshje ndryshe edhe pse luajnë shpejt, pasi kualiteti nuk është i njëjtë si ai i Spanjës, por besoj do të jetë një ndeshje ndryshe dhe do të kemi më shumë raste.

## Bostoni merr kreun në Lindje, Phoenixi i pandalshëm në Perëndim

Boston, 28 mars - Bostoni ka marrë kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores 134-112 të arritur ndaj Minnesotas. Ndeshje e dominuar nga ekipi i Celticsit, ku u dalluan Tatum me 34 pikë e Brown me 31 pikë e 10 rebounde. Në Perëndim dominon Phoenixi, që mundi 114-104 Philadelphian, dy ekipe pretendente këtë sezon për titull në NBA. Booker realizoi 35 pikë për Suns, duke i bërë të



pavlefshme 35 pikët e 15 rebounde e Embiidit. Tjetër humbje për Lakersat, që rrezikojnë edhe fazën "play-in". Ekipi kalifornian (LeBron James

REZULTATET	
Detroit - New York	102-104
Boston - Minnesota	134-112
Washington - Golden State	123-115
Phoenix - Philadelphia	114-104
New Orleans - Lakers	116-108
Brooklyn - Charlotte	110-119
Dallas - Utah Jazz	114-100

39 pikë) u mund me rezultat 116-108 nga New Orleans (Ingram 26 pikë). Brooklyn u mund me shifrat 119-110 nga Charlotte (La Melo Ball 33 pikë).

## Nadali synon të rikthehet në turneun e Romës

Rafael Nadal synon të luajë në turneun Masters të Romës pas rikuperimit të dëmtimit që pësoi 10 ditë më parë në Indian Wells. Tenisti spanjoll, numri 3 në botë, hoqi dorë nga turnetë e Barcelonës dhe Montekarlos, pasi mjekët e këshilluan një muaj pushim.

"Dalëngadalë dëmtimi po përqendrohet vetëm në një vend dhe jo në gjithë gjoksin. Po kryej disa ushtrime që nuk më japin dhimbje, në mënyrë që të ruaj sa më shumë formën fizike. Në këtë mënyrë, kur të nis stërvitjen me top të jem sa më në formë", ka thënë Nadal. "Nuk

shqetësohem, pasi do ta marr kohën e nevojshme për ta rikuperuar. Nuk rikthehem pa qenë në 100% të formës, për të evituar që problem të përsëritet. Mendoj se do të jem gati për në Romë, që do të jetë një test para Roland Garros", u shpreh Nadal. Tenisti spanjoll synon

triumfin numër 14 në grand slam-in parisien, turneu i tij i preferuar. Këtë vit Nadal ka humbur vetëm një ndeshje dhe fituar 20 prej tyre, duke qenë në formë. Gjithsesi, dëmtimi prishi disi planet e Nadalit, që synonte disa fitore në turnetë e fushave me dhe.

### SHKURT

#### 500 000 euro bonus për lojtarët e Maqedonisë së Veriut nëse kualifikohen në Kupën e Botës

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovacevski, ka udhëtuar së bashku me ekipin e futbollit drejt Portugalisë, ku përfaqësuesja e vendit të tij do të luajë ndeshjen e jetës. Ai ka premtuar një shpërblim prej 500 mijë eurosh nëse ata sigurojnë kualifikimin për në Kampionatin Botëror "Katar 2022".

"Ju jeni kampionë për ne, fituesit dhe krenaria e të gjithëve. Ne besojmë në ju dhe për këtë dua t'ju uroj suksese në ndeshjen me Portugalinë. Më e pakta që mund të bëjmë si qeveri është një çmim. 500 000 euro nëse kualifikoheni në Kupën e Botës", ka thënë kryeministri Kovacevski.

#### Kampioni ukrainas vritet në frontin e luftës në Mariupol

Kampioni botëror i kikkoksit ukrainas, Maksym Kagal, është vrarë në frontin e luftës në Mariupol. Lajmi është bërë me dije nga mediet e huaja se ai ishte bërë pjesë e forcave speciale në njësinë ushtarake në Azov, teksa lajmin për vdekjen e sportistit e kanë bërë me dije mediet ukrainase. "Fli i qetë vëlla, toka është e jotja, do të hakmerremi", ka thënë trajneri Oleg Skirt, cituar nga Ukrinform. Kujtojmë se Kagal ishte kampioni i parë botëror i kikkoksit në Iska (Shoqata Ndërkombëtare e Karatesë Sportive) në ekipin kombëtar të Ukrainës.

#### Rooney: Dua të bëhem trajner i Unitedit

Legjenda e Manchester Unitedit, Wayne Rooney, ka shprehur dëshirën që një ditë të jetë trajner i "Djajve të Kuq". Në një intervistë për gazetën britanike "The Sun", Rooney ka shprehur haptazi dëshirën të jetë trajner i Unitedit. Ai, gjithashtu, tregoi që Evertoni ka shfaqur interesim për të. "Më ofruan intervistën për punë në Everton, por dua të jem trajner i Manchester Unitedit", ishin fjalët e Rooneyt. "E di që nuk jam gati tani, por do të bëjë gjithçka që një ditë të ndodhë", ka shtuar ai. Rooney aktualisht është trajner në Derby County, ekip i ligës së dytë në futbollin e Anglisë.

#### Salahu mund t'i bashkohet Barcelonës

Futbollisti i Liverpoolit, Mohamed Salah, është afër largimit nga "Anfield" pas pesë vjetëve të kaluara në Angli. Sulmuesi nuk e ka vazhduar ende kontratën me "Reds" dhe, mesa duket, kjo nuk do të ndodhë. Ata duket se e dinë këtë edhe në Liverpool, ndaj do të tentojnë të fitojnë para duke e shitur, për të cilin klubet rreshtohen njëra pas tjetrës. E fundit në seri është Barcelona, e cila po përgatit një ofertë tronditëse për Salahun dhe po kërkon një mënyrë për ta tërhequr atë në Spanjë. Salahu ka një tjetër sezon të mrekullueshëm me 36 ndeshje, 20 gola dhe 10 asistime.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Albrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Leutrim isufi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Ganimete Terbeshi" Ponohec, Gjakovë.
- ▶ Dafina Avdijaj shpall të pavlefshme dëftesën e klasës , -X-, -XI-, -XII- të shkollës mesëm të Mjekësisë "Hyni Zajmi", Gjakovë.
- ▶ Kastriot Vula nga Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- ▶ Albehar Mullahasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.A.M.O "Kadri Kusari" –Teknik laborant i Biologjisë.
- ▶ Gentrit Dërmaku shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës "Junarodni Universitet Vranje".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

